

ANALIZË E MEDIAVE: DIPLOMACIA PUBLIKE E KINËS NË SHQIPËRI



ANALIZË E MEDIAVE:

**DIPLOMACIA PUBLIKE E KINËS
NË SHQIPËRI**

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative (BIRN Albania)
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë
<http://birn.eu.com/>

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
Rr. Muhamet Gjollësia, Nr. 9, Tiranë
<https://scidevcenter.org/>

Authors: Blerjana Bino
Besar Likmeta

Analiza e të dhënave: Jesmina Sengla

Përktheu në shqip: Durim Tabaku

Arti grafik: Jurgena Tahiri

© Balkan Investigative Reporting Network in Albania dhe Science &
Innovation for Development
Tirana, 2023



Funded by
the European Union

Ky raport u financua nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Opinionet, gjetjet, përfundimet apo rekomandimet e shprehura në të janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

I. **Hyrje** 7

Roli i Kinës në Ballkanin Perëndimor 9

Roli i Kinës në Shqipëri 12

Shënime për metodologjinë 15

II. **Gjetjet e analizës** 17

Tematikat kryesore që mbulohen nga CRI në gjuhën shqipe 17

Ekonomi 18
Aktualitet dhe kulturë shqiptare 19
Nga bota 20
Gjeopolitikë 21
Teknologji 22
Politika dhe shoqëria në Kinë 22

Tematika të tjera të përzgjedhura 23

Të drejtat e njeriut 23
NATO 24
Shtetet e Ballkanit 25
Bashkimi Evropian 25

	Nisma “Një brez, një rrugë”	26
	Pushtimi i Ukrainës nga Rusia	27
	Audienca e Kinës në Shqipëri	27
III.	Përfundime dhe rekomandime	29

I. Hyrje

Ndryshimet në pushtet janë element kyç që i jep formë dinamikës politike në të gjithë botën. Peizazhi global ka pësuar ndryshime të mëdha, ku një nga më të dukshmit është ngritja e Kinës në një pozicion me ndikim të madh.¹ Falë vendndodhjes së tij strategjike gjeopolitike dhe nevojës për investime në infrastrukturë, Ballkani Perëndimor ka tërhequr vëmendjen e Kinës. Ndikimi i kësaj të fundit në rajon është rritur përmes nismave si mekanizmi i bashkëpunimit 17+1 dhe Nisma ‘Një brez, një rrugë’, e cila synon të lidhë Kinën me Evropën përmes investimeve në infrastrukturë.²

Ngecja e proceseve të integritimit evropian në rajonin e Ballkanit Perëndimor ka krijuar një vakum për t’u mbushur nga aktorë të tjerë si Rusia dhe Kina. Pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia, BE-ja ka rritur përpjekjet e saj drejt zgjerimit.³ Gjithsesi, mjetet që Rusia po përdor për të minuar vendet demokratike kanë krijuar terrenin e përshtatshëm për ndikimin gërryes të Kinës dhe të fuqive të tjera autoritare.⁴ Raporti i Parlamentit Evropian 2022 mbi interesat strategjike të Kinës në Ballkanin Perëndimor thekson qasjen shumëplanëshe të Kinës që përfshin jo vetëm investime ekonomike, por

¹ Konrad Adenauer Stiftung. (2021). “Ndryshimet e pushtetit në botë”. Gjetet në adresën: <https://www.kas.de/en/web/auslandsinformationen/ausgaben/issues/-/content/global-power-shifts> Aksesuar më 31.03.2023

² Vangeli, Anastas (Ed.) (2022). Roli i Kinës në Evropën Juglindore. Friedrich Ebert Stiftung, Dialogu në EJL. Gjetet në adresën: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/athen/19416.pdf> Aksesuar më 31.03.2023.

³ “BE flirton me Ballkanin Perëndimor teksa Rusia dhe Kina po afrohen”, (2022). Politico. Gjetet në adresën: <https://www.politico.eu/article/eu-courts-western-balkans-as-russia-china-shadows-loom/> Aksesuar më 31.03.2023.

⁴ Qendra për Studimin e Demokracisë. (2023). “Thyerja e Kodit: Disinformimi rus dhe kinez dhe rrjedhat e paligjshme financiare në Evropën Juglindore”, gjetet në adresën: <https://csd.bg/publications/publication/breaking-the-code-russian-and-chinese-disinformation-and-illicit-financial-flows-in-southeast-europ/> Aksesuar më 31.03.2023.

edhe taktikat e fuqisë së butë.⁵ Në Shqipëri, Kina ka lidhje të thella historike dhe aktualisht është një partner kryesor tregtar, me investime në sektorë të ndryshëm.⁶

Në këtë analizë evidentohet propaganda kryesore e prodhuar nga mediat e sponsorizuara nga shteti kinez që operojnë brenda Shqipërisë, tematikë që, pavarësisht rëndësisë në rritje të saj, mbetet ende e pastudiuar mirë. Me rritjen e pranisë ekonomike dhe politike të Kinës në të gjithë botën, bëhet përherë e më e rëndësishme të kuptojmë se si e projekton ndikimin e saj dhe si i formëson ajo perceptimet në vend. Ky hulumtim është veçanërisht i rëndësishëm duke pasur parasysh zhvillimin e diplomacisë ekonomike dhe kulturore të Kinës në Shqipëri, dinamikën gjeopolitike në lojë⁷ dhe rolin jashtëzakonisht të madh që luajnë mediat në përhapjen e propagandës. Megjithatë, procesi nuk është pa kompleksitete, nëse marrim parasysh se për të kuptuar propagandën e ndërtuar nga mediat e sponsorizuara nga shteti kinez është me rëndësi tejet të madhe të analizojmë ndikimin dhe synimet e Pekinit.

Media luan një rol vendimtar në formësimin e propagandës dhe perceptimeve. Rritja e pranisë së mediave kineze në Shqipëri nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me mediat në vend dhe krijimit të degëve të institucioneve të mediave kineze ka potencialin të formësojë perceptimin dhe debatin publik për Kinën në vend. Ky studim synon ta zbërthejë këtë propagandë duke analizuar përmbajtjen e prodhuar nga mediat e sponsorizuara nga shteti kinez në Shqipëri, duke ofruar një

⁵ Parlamenti Evropian. (2022). Interesat strategjike të Kinës në Ballkanin Perëndimor. Gjetet në adresën: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/733558/EPRS_BRI\(2022\)733558_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/733558/EPRS_BRI(2022)733558_EN.pdf) Aksesuar më 31.05.2023.

⁶ Lami, Roland. (2022) Roli i Kinës në Shqipëri. Në analizë Roli i Kinës në Evropën Juglindore. Friedrich Ebert Stiftung, Dialogu në EJK, redaktuar nga Anastas Vangeli, Gjetet në adresën: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/athen/19416.pdf> Aksesuar më 31.03.2023. pp. 12-16.

⁷ Parlamenti Evropian. (2022). Interesat strategjike të Kinës në Ballkanin Perëndimor. Gjetet në adresën: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/733558/EPRS_BRI\(2022\)733558_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/733558/EPRS_BRI(2022)733558_EN.pdf) Aksesuar më 31.05.2023.

pikënisje për të kuptuar motivet, strategjitë dhe ndikimet e mundshme të përpjekjeve të diplomacisë publike të Kinës në Shqipëri. Studimi na bën të mundur të kuptojmë edhe nuancat e rolit të Kinës në vendin tonë, që është me rëndësi tejet të madhe për politikëbërësit, studiuesit dhe publikun e gjerë për të kuptuar ndryshimet në peizazhin gjeopolitik.

Kjo analizë kontribuon në diskutimin më të gjerë mbi diplomacinë publike të Kinës dhe ndikimin e saj global me fokus Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor. Nëpërmjet analizave rigoroze të përmbajtjes së mediave, ky raport shpreson të nxjerrë në pah kompleksitetin e ndikimit të Kinës në Shqipëri, të kontribuojë në debatin akademik dhe të shërbejë për përgatitjen e përgjigjes nëpërmjet politikave.



Roli i Kinës në Ballkanin Perëndimor

Që nga kriza financiare globale e vitit 2008-2009, ndikimi i Kinës në Ballkanin Perëndimor është rritur jashtëzakonisht shumë, deri në atë pikë sa perspektivat e sotme rajonale nuk mund të anashkalojnë marrëdhëniet me Pekinin, në kontrast të fortë me një dekadë më parë.⁸ Me rritjen e ndikimit të Kinës, shkaktohen reagime të ndryshme, duke nxitur kështu debate rreth qasjeve të përshtatshme të politikës së jashtme për të trajtuar fuqitë në rritje të vendeve joperëndimore. Këto diskutime janë intensifikuar për shkak të ngjarjeve globale, si pandemia Covid-19 dhe pushtimi i Ukrainës nga Rusia, të cilat i rrisin rëndësinë strategjike rolit të Kinës. Dialogët në lidhje me Kinën shpesh ndërliken me zhvillimin e brendshëm dhe çështjet e politikave, të ndërlikuara më tej nga

⁸ Friedrich Ebert Stiftung. (2022). Roli i Kinës në Evropën Juglindore. Friedrich Ebert Stiftung, Dialogu në EJL, redaktuar nga Anastas Vangeli, Gjetet në adresën: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/athen/19416.pdf> Aksesuar më 31.03.2023. p. 10.

dinamikat rajonale.⁹ Rëndësia e Kinës në përcaktimin e agjendës e ka drejtuar diskursin drejt zhvillimit ekonomik. Rritja e pranisë së Rusisë dhe Kinës në Ballkanin Perëndimor përbën një sfidë afatgjate për rajonin dhe sigurinë transatlantike.¹⁰

Pritshmëritë për përfitime ekonomike përmes tregtisë dhe investimeve janë faktorë madhorë që i japin formë imazhit të Kinës në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Prania e Kinës në rajon përforcohet shumë edhe nëpërmjet mediave lokale dhe kombëtare. Në përgjithësi, mbulimi nga mediat i rëndësisë ekonomike dhe aftësisë teknologjike të Kinës ka një element të fortë reklame, në mos manipulimi të drejtpërdrejtë. Në disa raste, mbulimi mediatik është jokritik dhe përmbajtja e ofruar nga media kineze thjesht riciklohet nga mediat e Evropës Juglindore.¹¹

Kina ka intensifikuar praninë e saj ekonomike në Ballkan pas ndikimit në rajon të krizës ekonomike botërore të vitit 2008, duke instrumentalizuar lodhjen që patën vendet e Ballkanit me zvarritjen e procesit të integritit dhe nevojën e vazhdueshme të tyre për investime në rajon.¹² Faktorët kryesorë që kanë nxitur rritjen e investimeve kineze në rajon janë mekanizmi i bashkëpunimit 16+1, i krijuar ndërmjet 16 vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Kinës, ku përfshihen të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përveç Kosovës. Ky bashkëpunim i hapi rrugë përfshirjes së këtyre vendeve në nismën ekonomike “Një brez, një rrugë”, nismë që synon të lidhë Kinën me Evropën përmes

⁹ Po aty. p. 3.

¹⁰ Zeneli, Valbona (2021). “Perëndimi, Kina dhe Rusia në Ballkanin Perëndimor”, gjendet në adresën: https://www.marshallcenter.org/sites/default/files/files/2020-10/pC_V10N3_en-4_Zeneli.pdf Aksesuar më 31.03.2023. p. 28

¹¹ Tonchev, Plamen., Petkova, Mirela., (2023). Ndikimi i fshehur i Kinës në Evropën Juglindore. Gjendet në adresën: <https://www.freiheit.org/sites/default/files/2023-01/2022-fnf-policy-paper-hidden-influence-final.pdf> Aksesuar më 31.03.2023. p.8.

¹² Parlamenti Evropian. (2022). Interesat strategjike të Kinës në Ballkanin Perëndimor. Gjendet në adresën: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/733558/EPRS_BRI\(2022\)733558_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/733558/EPRS_BRI(2022)733558_EN.pdf) Aksesuar më 31.05.2023.

investimeve në infrastrukturë në rreth 70 vende.¹³

Falë pozicionit të favorshëm gjeografik të tyre, vendet e Ballkanit Perëndimor janë me interes për Pekinin për zhvillimin e investimeve në infrastrukturë dhe rritjen e ndikimit në rajon. Duke shfrytëzuar nevojën e madhe për investime që ka rajoni, Kina ka investuar rreth 32 miliardë dollarë në 136 projekte që përqendrohen në sektorë strategjikë, si energjia, infrastruktura rrugore dhe ajo detare.¹⁴

Pjesa më e madhe e këtyre investimeve janë bërë në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Greqi dhe më pak në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri. Investimet ekonomike kineze kanë synuar objekte që tërheqin vëmendje të lartë publike, duke rritur kështu prestigjin e Kinës si një aktor në Ballkanin Perëndimor. Kjo strategji ndërthuret me një fushatë intensive të diplomacisë kulturore dhe ndërveprimit me elitat politike përmes shkëmbimeve dhe forumeve politike.¹⁵ Gjithsesi, ajo që është shqetësuese është se kreditë e investimeve kineze ndikojnë negativisht në procesin e integritimit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke qenë se këto kredi rrezikojnë të krijojnë varësi ekonomike ndaj Kinës, të ulin standardet mjedisore dhe të përjetësojnë politikat korruptive.¹⁶

¹³ Vulović, Marina. (2023). "Lidhjet e jashtme dhe të sigurisë të Ballkanit Perëndimor me aktorët e jashtëm". Gjetet në adresën: https://www.swp-berlin.org/publications/products/comments/2023C08_WesternBalkanTies_Web.pdf Aksesuar më 31.05.2023.

¹⁴ Më shumë këtu: <https://china.balkaninsight.com/>

¹⁵ Shopov, Vladimir. (2021). "Dekada e durimit: Si u bë Kina një fuqi në Ballkanin Perëndimor", gjendet në adresën: <https://ecfr.eu/publication/decade-of-patience-how-china-became-a-power-in-the-western-balkans/#an-ecosystem-of-shared-interests> Aksesuar më 31.05.2023.

¹⁶ Doehler, Austin., (2019). "Si e sfidon Kina BE-në në Ballkanin Perëndimor", gjendet në adresën: <https://thediplomat.com/2019/09/how-china-challenges-the-eu-in-the-western-balkans/> Aksesuar më 31.05.2023.

Roli i Kinës në Shqipëri

Historia e kohëve të fundit e marrëdhënieve Shqipëri-Kinë daton që në periudhën e Luftës së Ftohtë. Pas prishjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, Kina u bë partneri i vetëm i Shqipërisë deri kur kjo e fundit ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me të në vitin 1978, gjë që e zhyti vendin në izolim total. Nga partneriteti me Republikën Popullore të Kinës, Shqipëria plotësonte nevojat për mbështetje ekonomike dhe teknike, ndërsa për Kinën, Shqipëria ishte një mënyrë për të nxitur kritikën ndaj Bashkimit Sovjetik dhe për të përçuar kërkesat e saj në Kombet e Bashkuara, si në rastin e Rezolutës së paraqitur nga Shqipëria për njohjen e Republikës Popullore të Kinës si qeveri legjitime e Kinës. Që nga rënia e komunizmit, marrëdhëniet dypalëshe kinoshqiptare janë intensifikuar, veçanërisht pas vitit 2013, periudhë e cila përkon me krijimin e nismës ekonomike 16+1 mes Kinës dhe vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore, pjesë e së cilës është edhe Shqipëria.¹⁷

Në terma ekonomike, Kina është partneri i tretë kryesor tregtar i Shqipërisë dhe mbulon 8.9 për qind të totalit të importeve të vendit. Sipas një studimi të kryer nga BIRN në vitin 2021 për investimet kineze në Ballkan, në Shqipëri janë zhvilluar tetë projekte me investime kineze me vlerë rreth 649,859,803 euro. Projektet janë në sektorët e minierave dhe hidrokarbureve, në infrastrukturë si dhe sektorin kulturor dhe humanitar.¹⁸ Prania e investimeve kineze ishte më e dukshme në vitin 2016, kur kompania China Everbright Group siguroi koncesionin për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” në Tiranë. Koncesioni pritej të zgjaste deri në vitin 2027, por kompania kineze i shiti 100 për qind të aksioneve të saj në vitin 2020.¹⁹ Po ashtu, në vitin 2016, firma kineze Geo-Jade Petroleum bleu të gjitha aksionet e American Canadian Bankers Petroleum në Patos-

¹⁷ Për më shumë informacion: <http://al.china-embassy.gov.cn/eng/zaqx/sbgx/>

¹⁸ Për më shumë informacion: <https://china.balkaninsight.com/>

¹⁹ Për më shumë informacion: <https://www.monitor.al/sipermarrjet-qe-shiten-dhe-blene-aksione/>

Marinzë, që është zona naftëmbajtëse më e madhe në tokë në Evropë.²⁰

Për sa i përket fushës së medias dhe kulturës, sipas një raporti të Fondacionit gjerman Konrad Adenauer Stiftung, Kina e ka rritur praninë e saj mediatike dhe kulturore në Shqipëri.²¹ Në vitin 2012 pati shenja të rritjes së bashkëpunimit mes Agjencisë Telegrafike Shqiptare dhe Agjencisë së Lajmeve Xinhua²², ndërsa në vitin 2013 u krijua në Shqipëri një degë e Radios Ndërkombëtare FM të Kinës²³ si degë e Institutit Konfuci në Universitetin e Tiranës.²⁴

Po ashtu, në vitin 2019, Radio Televizioni Shqiptar nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë e Lajmeve Xinhua, ku parashikohej përhapja e përmbajtjeve mediatike si filma, dokumentarë, filma vizatimorë si dhe trajnime të përbashkëta të stafit. Kjo marrëveshje i hapi rrugë transmetimit të dokumentarëve mbi sistemin politik të Kinës, si “Kina: Epoka e Xisë”²⁵. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, gjatë viteve 2020-2022, Radio Televizioni Shqiptar publikoi 208 artikuj që kishin si burim Agjencinë e Lajmeve Xinhua. Në përgjithësi, lajmet mbulonin më shumë shkencën dhe kulturën sesa politikën. Në një studim të vitit 2020 numëroheshin mbi 1,000 artikuj për Kinën të botuar në vend gjatë pesë viteve. Gati gjysma e tyre, 47 për qind, e portretizonin Kinën në një dritë pozitive, 38 për qind ishin më negative dhe 15 për qind u

²⁰ Rapoza, Kenneth., (2016). “Shqipëria bëhet magneti më i fundit i Kinës”, gjendet në adresën <https://www.forbes.com/sites/kenrapoza/2016/06/13/albania-becomes-latest-china-magnet/?sh=1049b9d62490> Aksesuar më 31.05.2023.

²¹ Shopov, Vladimir. (2020). “Kapja nga radari – rritja e pranisë mediatike të Kinës në Evropën Juglindore”, gjendet në adresën: <https://www.kas.de/documents/281902/281951/%E2%80%9CChina%E2%80%99s+Rising+Media+Presence+in+South+East+Europe%E2%80%9D.pdf/0beb5c40-b6dd-7292-5cc3-fd8a5c1be824?version=1.1&t=1607417514942> Aksesuar më 31.05.2023.

²² Për më shumë informacion: <https://albanian.cri.cn/321/2012/09/20/61s117718.htm>

²³ Shih: <https://albanian.cri.cn/index.htm>

²⁴ Shih: <https://ciut.edu.al/>

²⁵ Për më shumë informacion: http://www.xinhuanet.com/english/europe/2019-10/20/c_138487215.htm

konsideruan artikuj të paanshëm.²⁶

Pavarësisht kësaj, prania ekonomike dhe mediatike e Kinës në kontekstin shqiptar mbetet e kufizuar. Sipas ekspertëve, arritjet e nismës 17+1 janë, po ashtu, modeste, ndërkohë që ndikimi ekonomik i Kinës në Shqipëri është thuajse inekzistent.²⁷ Ndikimi i kufizuar i investimeve kineze lidhet me dështimin për të përfunduar një sërë projektesh të mëdha, si Korridori Blu, një projekt me tetë vende për një autostradë bregdetare që kalon nga Sllovenia në Greqi nëpërmjet Shqipërisë ose tërheqja e kompanisë kineze nga Koncesioni i Rrugës së Arbrit që lidh Shqipërinë me Maqedoninë e Veriut.²⁸ Një tjetër faktor ndikues ka të bëjë me hezitimin e qeverisë shqiptare për të krijuar borxhe të mëdha ndaj Kinës, si në rastin e Rrugës së Arbrit²⁹ si dhe rritja e investimeve ekonomike dhe politike të SHBA-ve në Shqipëri.

Rritja e pranisë së Kinës në rajon bëri që ShBA-të të rifokusoheshin në Ballkanin Perëndimor dhe veçanërisht në Shqipëri, duke qenë se kjo e fundit ishte e para në rajon që iu bashkua nismës së Rrjetit të Pastër të ndërmarrë nga Presidenti Donald Trump në vitin 2020 për të sfiduar dominimin e firmave kineze në teknologjinë celulare 5G.³⁰ Në të njëjtin vit, SHBA-ja dhe Shqipëria nënshkruan një marrëveshje që i hapi rrugë investimeve në energji për Hidrocentralin e Skavicës dhe Termocentralin e Vlorës si përgjigje ndaj investimeve kineze në energji.³¹

²⁶ Feta, Bledar. (2022). "Ndikimi kinez në Shqipëri", gjendet në adresën: https://cepa.org/comprehensive-reports/chinese-influence-in-albania/#footnote_9_1152 Aksesuar më 31.05.2023.

²⁷ Shih: <https://www.zeramerikes.com/a/5613888.html>

²⁸ Shih: <https://ecfr.eu/special/china-balkans/albania/>

²⁹ BIRN. (2020). Kina në Ballkanin Perëndimor. Gjendet në adresën: <https://consultancy.birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/05/China-in-the-Western-Balkans-April-2020.pdf> Aksesuar më 31.05.2023.

³⁰ Politika e Jashtme. (2022). "Shqipëria është një fushë beteje e re brezi dhe rruge", gjendet në adresën: <https://foreignpolicy.com/2022/01/24/albania-china-bri-us-europe-geopolitics/> Aksesuar më 31.05.2023.

³¹ Politika e Jashtme. (2022). "Shqipëria është një fushë beteje e re brezi dhe rruge", gjendet në adresën: <https://foreignpolicy.com/2022/01/24/albania-china-bri-us-europe-geopolitics/> Aksesuar më 31.05.2023.

Imazhi i Kinës në Shqipëri formësohet nga konteksti historik, marrëdhëniet tregtare dhe qëndrimi diplomatik i Kinës për çështjet kyçe të politikës. Në Barometrin e Sigurisë Shqipëri 2020, botuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, CSGD, një organizatë hulumtuese shqiptare, evidentohet se në vitin 2020, 54.9 për qind e të anketuarve e konsideronin ndikimin e Kinës në sigurinë e Shqipërisë si pozitiv. Edhe pse këto shifra tregonin përmirësime krahasuar me një vit më parë (2019), shpërthimi i pandemisë Covid-19 mund ta ketë gërryer këtë mbështetje, pavarësisht furnizimit nga Kina të sasive të mëdha të vaksinave për Shqipërinë në vitin 2019. Nga ana tjetër, qëndrimi diplomatik i palëkundur dhe i pandryshuar i Kinës për mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës ndikon në pikëpamjet e pafavorshme që shumë shqiptarë kanë për Kinën.³²



Shënime për metodologjinë

Për të monitoruar diplomacinë publike të Kinës në Shqipëri përmes mediave të saj të sponsorizuara nga shteti, për qëllimin e kësaj analize, u qëmtua dhe u analizua në mënyrë cilësore një kampion i rastësishëm artikujsh të botuar nga China Radio International (CRI), në gjuhën shqipe në periudhën 22 gusht 2021 deri më 21 gusht 2022.

Artikujt u qëmtuan nga CRI-ja duke përdorur SentiOne, një instrument online dëgjimi dhe analize që funksionon me inteligjencë artificiale. U qëmtua dhe u kodua një kampion prej 20 për qind artikujsh të zgjedhur në mënyrë rastësore të botuar nga CRI-ja gjatë 12 muajve për të identifikuar tematikat dhe mesazhet kryesore.

³² Tonchev, Plamen., Petkova, Mirela., (2023). Ndikimi i fshehur i Kinës në Evropën Juglindore. Gjetet në adresën: <https://www.freiheit.org/sites/default/files/2023-01/2022-fnf-policy-paper-hidden-influence-final.pdf> Aksesuar më 31.03.2023. p. 10.

Pas kategorizimit dhe etiketimit në një bazë të dhënash Excel bazuar në tematika të nivelit të lartë, artikujt u analizuan në mënyrë cilësore për të kuptuar mesazhet e mediave shqipfolëse të sponsorizuara nga shteti kinez, bazuar në kategori të caktuara.

Përveç tematikave të nivelit të lartë që u identifikuan, u krye një analizë e artikujve bazuar edhe në tematikat me interes të listuara si më poshtë për të kuptuar më thellë mesazhet e Kinës për tematika të veçanta, përfshirë këtu mbulimin për: Bashkimin Evropian; NATO-n; vendet e Ballkanit; pushtimin e Ukrainës nga Rusia; të drejtat e njeriut; dhe Nismën “Një Brez, Një Rrugë”.

Për të kuptuar më mirë audiencën që CRI-ja synon të arrijë përmes kanaleve të saj në gjuhën shqipe në mediat sociale, u krye një analizë e ndërveprimit me postimet në mediave sociale të CRI-së për periudhën gusht 2021 deri në gusht 2022 duke përdorur aplikacionin Crowdtangle në pronësi të konglomeratit Meta.

II. Gjetjet e analizës


Gjatë periudhës 12 mujore, 22 gusht 2021 - 21 gusht 2022, Radio China International (CRI) publikoi përmes shërbimit të saj në gjuhën shqipe³³ rreth 5,200 artikuj. Për shkak të sasisë së madhe të të dhënave, studiuesit përzgjodhën për analizën e përmbajtjes një kampion rastësor prej 20 për qind (n=1,060) të artikujve të botuar nga CRI gjatë periudhës në analizë.

Tematikat kryesore që mbulohe nga CRI në gjuhën shqipe

Nëpërmjet analizës cilësore, tematikat më të përsëritura që trajtohen nga artikujt e botuar nga CRI-ja në gjuhën shqipe janë: Ekonomi, Kulturë Shqiptare, (Lajme) Nga bota, Aktualitet shqiptar, Gjeopolitikë, Teknologji, dhe Politika dhe Shoqëria Kinë. Këto tematika përbëjnë 84 për qind të të gjithë artikujve të botuar, ndërsa artikujt e tjerë mbulonin tematika të tjera si COVID-19, Kulturë kineze, Mjedisi, Të drejtat e njeriut, dhe Ushtria dhe siguria.

³³ <https://albanian.cri.cn/>

PËRQINDJA E TEMATIKAVE KRYESORE QË MBULOHEN NGA CRI NË GJUHËN SHQIPE



Më poshtë jepet një përmbledhje e mesazheve kryesore të identifikuara nga analiza cilësore e artikujve të publikuar sipas çdo tematike kryesore që mbulohej nga shërbimi në shqip i CRI-së.



Ekonomi

Ekonomia është tematika e vetme më e njohur e nivelit të lartë në transmetimet e CRI-së në shqip

dhe përbën 15.85 për qind të totalit të artikujve në kampionin e marrë në analizë. Në këtë tematikë përfshihen artikuj që mbulojnë zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë në Kinë, duke i kushtuar një hapësirë të veçantë nismës “Një brez, një rrugë”. Në to evidentohen kryesisht arritjet në këtë nismë, ndërkohë që kritikant ndaj kësaj nisme sulmohen si të pabaza. Rajonet kineze të kritikuara nga SHBA-ja për punën e detyruar të pakicës ujgure portretizohen sikur po përjetojnë një zhvillim të mirë ekonomik. Nën këtë tematikë janë edhe artikujt e botuar për prodhimin dhe konsumin e mallrave në Kinë, tregtinë elektronike, financat, tatimet, marketingun dhe reklamën, infrastrukturën e transportit, tregtinë, energjinë, minierat, bujqësinë dhe industrinë.

Në kampionin e artikujve të marrë në analizë, Kina paraqitet si vend me rritje të shpejtë ekonomike në krahasim me vendet e tjera (SHBA, Japoni, vendet e BE-së), të cilat po vuajnë nga recesioni. Mesazhi kinez në këtë tematikë pretendon se Pekini ishte në gjendje t'i përgjigjej në kohë reale pandemisë Covid-19. Me këtë mesazh pretendohet se masat e ndërmarra nga Kina për të trajtuar krizën energjetike ishin jo vetëm efektive, por edhe novatore dhe miqësore me mjedisin. Kina përshkruhet si promotore e palëkundur e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, veçanërisht në lidhje me uljen e varfërisë, menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Shembuj të titujve kryesorë:

“Kinë, investimet në transport u rritën me 6.7% në gjysmën e parë të vitit.”
“Xinjiang-u i Kinës, rritje të qëndrueshme industriale në gjysmëvitin e parë”

Aktualitet dhe kulturë shqiptare

Në kampionin prej 1,060 artikujsh, 293 prej tyre mbulonin lajmet për Shqipërinë (tematikat “Aktualitet/kulturë shqiptare”), duke përbërë 27.6 për qind të totalit të kampionit të artikujve të botuar nga CRI në shqip gjatë 12 muajve që mbaronin në gusht 2022.

Pjesa më e madhe e artikujve të tematikës “Kulturë Shqiptare” ishin histori me interes njerëzor për yjet e sportit dhe muzikës shqiptare në vend dhe diasporë. Ndërkohë, mbulimi i aktualitetit përfshinte lajme për ekonominë, politikën dhe shoqërinë shqiptare si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Toni i këtij mbulimi është neutral duke cituar si burim deklaratat e zyrtarëve publikë/ministrat e kabinetit apo raportimet nga transmetuesi publik shqiptar, RTSH. Kjo e fundit në vitin 2019 nënshkroi me CRI-në një marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e përmbajtjeve. RTSH-ja është cituar si burim lajmi 43 herë ose në rreth 15% të artikujve të kësaj kategorie.

Shembuj të titujve kryesorë:

“Festivali “Sunny Hill” vjen në Tiranë, Rama: Do të ndriçojnë netët e kryeqytetit”
“Kampionia Luiza Gega nderohet me medalje”

Nga bota

“Nga bota” përbën 14.6 për qind të numrit të përgjithshëm të artikujve dhe është tematika me nivelin më të lartë të njëanshmërisë në kampionin e artikujve të analizuar nga ky hulumtim. Në këtë tematikë përfshiheshin lajmet për aktualitetin në botë, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara, Japonia, vendet e Azisë Juglindore, Irani, Rusia, India dhe Afrika. Pothuajse të gjithë artikujt e lajmeve për SHBA-në ishin kritikë dhe përçonin mesazhe për dështimet e qeverisë amerikane për të trajtuar pandeminë Covid-19, lëkundjen e besimit tek institucionet demokratike, recesionin ekonomik, rritjen e shkallës së krimit dhe fenomene të tjera negative.

Po ashtu, artikujt për Japoninë, që është një tjetër konkurrent strategjik i Kinës, e portretizojnë ekonominë këtij vendi në rënie. Përveç kësaj, në kontekstin evropian, mbizotërojnë lajmet për recesionin ekonomik, grevat e punëtorëve dhe rritjen e kostos së jetesës. Ndërkohë, lajmet e botuara

në këtë tematikë për vendet afrikane i vënë theksin kontributit pozitiv të Kinës në kontinent.

Shembuj të titujve kryesorë:

“Dështimi i politikave të klimës të ShBA-së”

Sondazhi: Bie besimi i amerikanëve te udhëheqësit e qeverisë

Gjeopolitikë

Artikujt e tematikës “Gjeopolitikë” përbëjnë 10.6 për qind të totalit të publikimeve të bëra nga CRI-ja. Këta artikuj mbulojnë kryesisht ngjarje dhe njerëz që strukturojnë marrëdhëniet e Kinës me fqinjët e saj dhe botën më gjerë. Marrëdhëniet e Kinës me Tajvanin dhe pretendimi i saj për ishullin është temë qendrore e këtij grupi artikujsh. Nga totali prej 115 artikujsh nën këtë tematikë, 24 kanë të bëjnë me Tajvanin. Artikujt propagandojnë parimin “Një Kinë” ndaj Tajvanit dhe dënojnë në mënyrë të veçantë vizitën në ishull të ish-kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-ve, Nancy Pelosi. Kjo e fundit e vizitoi Tajvanin më 2 gusht 2022 së bashku me pesë anëtarë të Partisë Demokratike të Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-ve në një udhëtim dyditor si pjesë e turneut të saj në Azi. Ndonëse administrata Biden e dekurajoi vizitën e Pelosit në Tajvan, ajo nuk e pengoi atë. Vizita u dënua nga Kina me mesazhe të ashpra që u shfaqën në mediat e saj të sponsorizuara nga shteti, duke përfshirë edhe botimin në gjuhën shqipe të CRI-së. CRI-ja i kushtoi nëntë artikuj vizitës së Pelosit. Në këta artikuj zyrtarët kinezë paralajmëruan se vizita ishte provokuese dhe shkelje e sovranitetit të Kinës si dhe paralajmëruan edhe vendet e tjera që të mos ndjekin hapat e SHBA-ve. Artikujt e publikuara nga CRI-ja i bënin jehonë edhe reagimit diplomatik dhe ushtarak të Kinës ndaj vizitës së Pelosit në Tajvan.

Shembuj të titujve kryesorë:

“Kina shpall kundërmaset ndaj vizitës së Pelosit në Tajvan”
“Presidenti kenian: Rrugët e ndërtuara nga Kina nxisin zhvillimin e vendit”

Teknologji

Në kampionin e marrë në analizë janë 83 artikuj, afërsisht 8 për qind e totalit të artikujve të këtij kampioni, që lidhen me tematikën e teknologjisë. Këta artikuj mbulojnë mesazhe për teknologji të veçantë, si makinat elektrike, telefonat inteligjentë të prodhuar në Kinë, projektet energjetike, infrastruktura e teknologjisë së informacionit, teknologjia e transferimit të të dhënave të telekomunikacionit 5G, eksplorimi i hapësirës, ose artikujt për produktet dhe shërbimet e korporatave të mëdha kineze ose markave të njohura si Xiaomi dhe Huawei.

Shembuj të titujve kryesorë:

“Ministria: Kina ka 475 milionë përdorues celularësh 5G”
“Vihet në funksionim sateliti i ri kuantik i Kinës”

Politika dhe shoqëria në Kinë

Në total ishin 80 artikuj të kësaj tematike në kampionin e rishikuar, ose 7.5 për qind e totalit. Mesazhet në artikujt e kësaj tematike lidhen me deklaratat e bëra nga zyrtarët kinezë – Presidenti Xi Jinping dhe të tjerë – për shumë aspekte, përfshirë këtu zhvillimin ekonomik, globalizimin, arsimin, inovacionin, transportin dhe bujqësinë.



Tematika të tjera të përzgjedhura

Përveç identifikimit dhe analizimit të tematikave të nivelit të lartë të artikujve të botuar nga CRI-ja në gjuhën shqipe, hulumtuesit analizuan edhe përmbajtjen e lajmeve sipas tematikave të përzgjedhura që janë me interes, përfshirë këtu artikuj për të drejtat e njeriut, Bashkimin Evropian, NATO-n, vendet e Ballkanit, nismën ekonomike “Një brez, një rrugë” dhe pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Këto tematika me interes u përzgjedhën bazuar në shqyrtimin e literaturës së raporteve mbi fushatat e ndikimit të Kinës në botë, stabilitetin dhe sigurinë në rajon dhe aspiratat e saj demokratike.



Të drejtat e njeriut

Nga kampioni i përgjithshëm i artikujve të marrë në analizë, 15 u klasifikuan në tematikën e të drejtave të njeriut. Mesazhi nga këta artikuj fokusohet te të drejtat e pakicave në Kinë, duke pretenduar se ato respektohen mirë dhe se kritikrat ndaj Pekinit, shpesh nga Shtetet e Bashkuara, janë të pabaza. Këtu përfshihen kritikrat e vendeve perëndimore për të dhënat në lidhje me të drejtat e njeriut në Xinjiang dhe Tibet. Xinjangu është rajon autonom i Kinës verilindore i populluar nga uigurët, një grup etnik mysliman turqishtfolës. Sipas raportit vjetor për të drejtat e njeriut të Departamentit Amerikan të Shtetit dhe tekstet e miratuara nga [Parlamenti Evropian](#), Pekini është përgjegjës për abuzime serioze me të drejtat e njeriut në Xinjiang, përfshirë këtu dëbimin masiv, indoktrinimin politik, ndarjen e familjes, kufizimet mbi lirinë fetare, shkatërrimin kulturor dhe përdorimin në shkallë të gjerë të mbikëqyrjes.

Pjesë nga artikulli:

“Nga vargu i shpifjeve të pafund lidhur me të drejtat e njeriut në Republikën Popullore të Kinës, e veçanërisht në rajonin autonom Xinjiang-Ujgur që shtrihet në pjesën veriperëndimore të këtij vendi të madh aziatik, trillime të cilat institucionet e ndryshme të SHBA-së po i shpërndajnë me zell hysterik veçanërisht këta muajt e fundit nëpërmjet mjeteve të tyre të propagandës apo edhe deklaratave të politikëbërësve të lartë të saj, sa në vend të tyre e sa në veprimtari të aleancave të mbyllura të kryesuara prej saj, duket qartë se Uashingtoni e ka humbur fillin e logjikës së një shteti të madh normal e serioz, duke iu rikthyer vijës së vjetër të sjelljes si ‘xhandar ndërkombëtar’ ndaj të gjithë popujve të botës që i konsideron ‘jo miqësor’.”

NATO

Në kampionin e artikujve të botuar nga CRI-ja katër artikuj kishin të bënin me NATO-n, themelin e aleancës ushtarake mes Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara. Fokusi kryesor ishte zgjerimi i NATO-s me dy vende të reja që aplikuan për t’iu bashkuar aleancës pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Kërkesat e Suedisë dhe Finlandës për anëtarësim në aleancë u bllokuan nga Turqia, që është edhe fokusi i shkrimeve.

Mesazhi nga mediat e sponsorizuara nga shteti kinez është se përfshirja e Finlandës dhe Suedisë në NATO do të krijonte paqëndrueshmëri në infrastrukturën e sigurisë në Evropë. Në këta artikuj ngrihet pretendimi se duke braktisur neutralitetin e tyre këto dy vende thyen ekuilibrat që ishin vendosur tashmë mes blloqeve ushtarake dhe gjeopolitike.

Shembuj të titujve kryesorë:

“Turqia mban rezerva për ofertat e nordikëve në NATO”

Pjesë nga artikulli:

“Insinuatat e kreut të NATO-s Stoltenberg mbi qëndrimin e Kinës ndaj luftës në Ukrainë si ‘një stuhi në një gotë çaji’.”

Shtetet e Ballkanit

Tetë artikuj në kampionin e marrë në analizë fokusohen te vendet e tjera të Ballkanit përveç Shqipërisë. Në këto vende përfshihen Greqia, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia. Artikujt e përzgjedhur nënvizojnë rritjen e pranisë dhe ndikimit të Kinës në rajon. Kina portretizohet si partner i qëndrueshëm dhe i besueshëm që i përgjigjet nevojave të rajonit. Artikujt fokusohen në bashkëpunimin mes Greqisë dhe Kinës por edhe në forcimin e lidhjeve mes Pekinit dhe vendeve të tjera të rajonit.

Shembull i titujve kryesorë:

“Kina dhe Greqia zotohen të thellojnë më tej bashkëpunimin me përfitim reciprok”

Bashkimi Evropian

BE-ja është kryefjala e pesë artikujve të botuar nga CRI-ja në gjuhën shqipe në kampionin e marrë në analizë. Këta artikuj nxjerrin kryesisht në pah ndërvarësinë e Evropës ndaj Shteteve të Bashkuara dhe mënyrën se si Unioni duhet të çlirohet nga ndikimi i Uashingtonit në politikat e tij të

sigurisë. Propaganda për BE-në lidhet kryesisht me kontekstin e tensioneve mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara për dy çështje kyçe: e para është vizita në Tajvan e ish-kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-ve, Pelosi, dhe parimi “Një Kinë”. E dyta lidhet me qëndrimin e BE-së ndaj pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Kina sulmon atë që ajo e quan qëndrim të paqartë të BE-së ndaj politikës “Një Kinë” ndaj Tajvanit gjatë vizitës së Pelosit në ishull. Po ashtu, mesazhi që përcillet nga CRI-ja pretendon se Shtetet e Bashkuara nuk janë të interesuara për paqen në Ukrainë dhe se po minojnë pavarësinë strategjike të Evropës.

Shembull i titujve kryesorë:

“CMG-ja: Evropa duhet ta marrë vetë në dorë sigurinë e vet”

Nisma “Një brez, një rrugë”

Në kampionin e artikujve të shqyrtuar bënin pjesë 10 lajme që fokusoheshin në Nismën “Një brez, një rrugë”. Nisma është një strategji zhvillimi e miratuar nga qeveria kineze në vitin 2013 për të investuar në qindra vende me qëllim përmirësimin e infrastrukturës që bën të mundur dërgimin e mallrave kinezë në tregjet perëndimore. Nisma konsiderohet si pjesa qendrore e politikës së jashtme të Kinës në drejtimin e Presidentit Xi Jinping, nën strategjinë e tij të “Diplomacisë Kryesore të Vëndit”, në të cilën i bëhet thirrje Kinës të marrë një rol më të madh në përputhje me statusin e fuqisë së saj në rritje. Artikujt e publikuar nga CRI-ja fokusohen në suksesin e nismës në nxitjen e tregtisë dhe ngritjes së pozicionit të Kinës në arenën botërore.

Shembull i titujve kryesorë:

“Nisma “Një brez, një rrugë” është e fortë dhe më shumë lajme të mira do të vijnë.”



Pushtimi i Ukrainës nga Rusia

Në kampionin e artikujve të CRI-së, 11 lajme fokusohen në agresionin e Ruisë ndaj Ukrainës. Në këta artikuj, mesazhi që vjen nga Pekini është se Kina mbështet vendosjen e dialogut mes Kievit dhe Moskës për të gjetur një zgjidhje për konfliktin. Megjithatë, pavarësisht qëndrimit për paqe, Kina nuk i mbështet sanksionet perëndimore kundër Ruisë duke këmbëngulur se ato do të dëmtojnë ekonominë globale. Lajmet mbulojnë deklaratat nga presidenti rus Vladimir Putin dhe ai ukrainas Volodymyr Zelensky për konfliktin, por edhe deklaratat nga vende të tjera përfshirë këtu Turqinë, Kinën dhe Brazilin, ku bëhet thirrje për bashkëpunim mes palëve ndërluftuese.



Audienca e Kinës në Shqipëri

Përveç publikimit në faqen e saj në internet, nga viti 2013, CRI-ja nisi transmetimet edhe nëpërmjet Radios Eajani, në frekuencën FM 106MHz në qarkun e Tiranës dhe Durrësit. Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare ose komerciale për audiencën e stacioneve radiofonike dhe për lexuesit e mediave online në Shqipëri, në këtë analizë u përdorën të dhënat për ndërveprimin me ndjekësit e profilit të saj në mediat sociale në Facebook.


Në 12 muajt nga 22 gusht 2021 deri më 21 gusht 2022, CRI-ja në gjuhën shqipe publikoi 9,333 postime në profilin e saj në Facebook dhe regjistroi në total 152,660 ndërveprime. Rreth 51 për qind e këtyre postimeve ishin foto, 21 për qind ishin video nga vendi dhe 28 për qind ishin lidhje të artikujve në faqen e saj në internet.

Pjesa më e madhe e ndërveprimeve u krijuan nga postimet në formën e fotografive me 47 për qind të totalit të ndërveprimeve, të ndjekura nga videot nga vendi me 44 për qind. Vetëm 9 për qind

e ndërveprimeve shkuan në lidhjet e artikujve të shpërndarë në Facebook. Videot e postuara në kanalën në gjuhën shqipe të CRI morën gjithsej 18.1 milionë shikime.

Kanali tjetër në shqip i Kinës në mediat sociale është profili në Facebook i ambasadës kineze në Tiranë. Faqja e ambasadës publikoi gjithsej 294 postime, përfshirë këtu lidhje të artikujve, foto dhe video, gjatë periudhës në fjalë (gusht 2021 - gusht 2022). Këto postime morën 3,241 ndërveprime me 8.5 milionë shikime në postimet e videove.

TOTALI I NDËRVEPRIMEVE



III. Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në analizën e gjerë të përmbajtjes së artikujve të botuar në gjuhën shqipe nga China Radio International, mund të përmbliidhen disa opinione kryesore:

- Mbulimi i Shqipërisë: Përmbajtja e artikujve që mbulonin Shqipërinë, si në aspektin e kulturës dhe aktualitetit të saj, ishte kryesisht neutrale. Kjo tregon interesin e madh që ka Kina për Shqipërinë.
- Propaganda ekonomike: CRI-ja e portretizon Kinën si një ekonomi me rritje të shpejtë, novatore dhe të qëndrueshme, shpesh duke e nxjerrë në avantazh në krahasim me SHBA-të, Japoninë dhe vendet e BE-së.
- Njëanshmëri për lajmet nga bota: Evidentohet njëanshmëri e qartë në mbulimin e lajmeve nga bota, me fokus kritik ndaj SHBA-ve, Japonisë dhe Evropës, ndërsa kombet afrikane portretizohen në një dritë më pozitive për shkak të ndikimit në rritje të Kinës në ato vende.
- Pozicionimi gjeopolitik: Mbulimi i gjeopolitikës përqendrohej më së shumti në marrëdhëniet e Kinës me Tajvanin, duke e paraqitur në një kuadër negativ përfshirjen e SHBA-ve në rajon. Lajmet e tjera mbulonin mosmarrëveshjet rajonale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.
- Teknologjia & shoqëria: Përparimi teknologjik i Kinës dhe pikëpamjet e udhëheqjes së saj për aspekte të ndryshme shoqërore ishin tematikë që përsëritej vazhdimisht në artikuj.
- NATO-ja, Ballkani, BE-ja: Mbulimi i NATO-s nga Kina përqendrohej në zgjerimin e aleancës, duke i bërë jehonë paqëndrueshmërisë së saj. Vendet e Ballkanit portretizohen se kishin marrëdhënie pozitive dhe në përmirësim me Kinën. Mbulimi i BE-së kishte për qëllim mbjelljen e mosmarrëveshjeve mes BE-së dhe SHBA-ve.
- Nisma “Një brez, një rrugë”: Artikujt e portretizonin Nismën “Një brez, një rrugë” si një strategji të suksesshme që nxit tregtinë dhe rrit ndikimin e Kinës në botë.

- Të drejtat e njeriut: Artikujt për të drejtat e njeriut tentonin të hidhnin poshtë kritikën e Perëndimit dhe pretendonin se në Kinë, veçanërisht në Xinjiang dhe Tibet, tregohet respekt për të drejtat e pakicave.
- Pushtimi i Ukrainës nga Rusia: Qëndrimi i Kinës për konfliktin përshkruhet si neutral, duke favorizuar dialogun mbi sanksionet.
- Ndërveprimi i audiencës: Postimet më tërheqëse në kanalet e mediave sociale të CRI-së në gjuhën shqipe ishin ato me foto dhe video nga vendi. Numri i ndërveprimeve në këto platforma është tregues i një audience të konsiderueshme në Shqipëri.

Nga kjo analizë del në pah se mediat në gjuhën shqipe të CRI-së shërbejnë si mjet për diplomacinë publike të Kinës në Shqipëri, duke synuar të krijojnë një opinion publik në favor të Kinës. Në këtë analizë evidentohen edhe interesat dhe strategjia gjeopolitike, ekonomike dhe shoqërore të Kinës për ndikimin global.

Bazuar në gjetjet e kësaj analize mund të rekomandojmë sa më poshtë:

- Zgjerimi i njohurive për mediat dhe informacionin: Të edukohet popullata në Shqipëri për natyrën dhe objektivat e mediave të huaja të sponsorizuara nga shteti. Këtu të përfshihet edhe nevoja për të kuptuar rolin që luajnë këto media në përhapjen e propagandës për t'i shërbyer interesave të qeverisë që i sponsorizon
- Diversifikimi i burimeve të lajmeve: Të nxiten shqiptarët të aksesojnë një gamë më të gjerë burimesh të lajmeve, përfshirë këtu mediat e pavarura nga vende të ndryshme, për të krijuar një pikëpamje më të ekuilibruar të ngjarjeve në botë.
- Përmirësimi i mediave në vend: Të jepet mbështetje për mediat shqiptare për prodhimin e përmbajtjeve me cilësi të lartë që tërheq audiencë dhe që mund të konkurrojnë me mediat e huaja. Një gjë e tillë do të ulë varësinë ndaj mediave të huaja për lajme dhe informacione.
- Nismat e verifikimit të fakteve: Të forcohen nismat aktuale për verifikimin e fakteve të artikujve,

veçanërisht të atyre që vijnë nga mediat e sponsorizuara nga shteti, për të siguruar saktësinë e informacionit që publikohet.

- Transparenca në bashkëpunim: Nëse mediat në vend bashkëpunojnë me mediat e huaja të sponsorizuara nga shteti, të tillë si CRI-ja, duhet të respektohet transparenca për natyrën e marrëdhënieve të tyre dhe e përmbajtjes së publikuar.
- Monitorimi i ndikimit të mediave të huaja: Të vazhdohet me monitorimin dhe analizimin e përmbajtës së mediave të sponsorizuara nga shteti për të kuptuar strategjitë e tyre të propagandës, tematikat dhe ndikimin e mundshëm tek opinioni publik.
- Përpyekjet e diplomacisë publike: Të shtohen përpyekjet e diplomacisë publike të Shqipërisë për të komunikuar në mënyrë efektive qëndrimin e saj për çështje kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe për të luftuar ndikimin e mundshëm nga mediat e huaja të sponsorizuara nga shteti.
- Trajtimi i propagandës së të drejtave të njeriut: Të organizohen diskutime të hapura për problematikat e të drejtave të njeriut në Kinë dhe gjetkë, duke siguruar që shqiptarët të marrin informacione objektive për këto çështje të rëndësishme.
- Përgjigja ndaj disinformimit: Të hartohet një strategji efektive për t'iu përgjigjur fushatave të mundshme të disinformimit, duke siguruar që publiku të jetë i informuar dhe të mund të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin që konsumon.

ANALIZË E MEDIAVE:
**DIPLOMACIA PUBLIKE E KINËS
NË SHQIPËRI**



© Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative

Tiranë, 2023